



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 7 dhjetor 2015, në mbledhjen XIX – të (nëntëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.35'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti Bahri Selimi, Shaban Osmani, Radisav Perović, Xhafer Ademi dhe Xhevdet Beselica, ndërsa mungoi Mefail Rama.

Me këtë u koristatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Halit Vërshevci, shef i Sektorit të Shëndetësisë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Fatlume Delija, kryesuese e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës Mitrovicë Veriore, Skender Shatri dhe Bekim Karaxhija OSBE dhe përfaqësuesi i KFOR – it.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

### **2. Informatë për ecurinë e hartimit të propozimit të Planit të Veprimit për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës për periudhën 2016-2019**

**Liman Zeqiri**, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, jam i mendimit se propozimi i planit për të cilin po debatohet së shpejti do të shqyrtohet në këtë Komitet e pastaj do të shqyrtohet në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës dhe do të jetë një dokument zyrtar për integrimin e komuniteteve RAE.

Grupi punues i cili ka marrë pjesë në hartimin e këtij propozim Planit është angazhuar maksimalisht dhe në katër takimet e mbajtura e ka dhënë kontributin e vet, pastaj disa anëtarë të Komitetit për Komunitete. Gjithashtu e shfrytëzoj rastin dhe i falënderoj të gjitha Drejtoritë relevante për punën e tyre në ofrimin e të dhënavë të nevojshme.

Në veçanti për kontributin mjaftë të madh në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm për Komunën tonë dëshiroj ta falënderoj OSBE – në e cila na ka ndihmuar në aspektin material por edhe me ide e sugjerime dhe aspekte të tjera.

Në vazhdim në detaje paraqiti bazën në të cilën mbështetët propozimi i këtij Plani si dhe përbajtjen përkatësisht pesë shtyllat kryesore të propozimit të këtij dokumenti.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, kërkoj falje që në fillim nuk ju informova se në mbledhje është e pranishme z. Fatlume Delija, kryesuese e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore, të cilën e përshëndes dhe i uroj suksese në punën e saj të mëtejshme.

**z. Fatlume Delija**, i përshëndeti të pranishmit dhe shtoi, jam kryesuese e Komitetit për Komunitete njëherit këshilltare e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore. Komiteti për Komunitete në komunën tonë është themeluar kohë më parë dhe unë jam e interesuar që të shkëmbejmë përvojat në mënyrë që puna e jonë e ardhshme të jetë sa më e sukseshtme dhe përfundoj Juve ju uroj suksese dhe punë të mbarë.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në mënyrë shumë të qartë e paraqiti Informatën për securinë e hartimit të Planit të Veprimit për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Podujevës për periudhën 2016-2020, mirëpo mendimin tonë do ta japim kur ky dokument do të shqyrtohet në këtë Komitet, e pas miratimit në Kuvend të Komunës, siç tha z. Liman Zeqiri, duhet angazhuar për zbatimin në praktikë të njëjtit.

Shfrytëzoj rastin dhe i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit të cilët kanë punuar në hartimin e propozimit të këtij plani duke përfshirë edhe OSBE – në e cila ka ofruar mbështetje të pa rezervë.

**z. Bekim Karagjija**, theksoi, u përmend disa herë mbështetja e OSBE – së për hartimin e propozimit të këtij plani, por realiteti është se puna kryesore është bërë nga përfaqësuesit e Komunës, OSBE vetëm e ka iniciuar çështjen ndërsa angazhimi dhe puna është bërë prej zyrtarëve komunal.

Përndryshe propozimi i planit është mjaftë i mirë dhe i detajuar dhe në krahasim me disa komuna të tjera të cilat i kemi marrë model për hartimin e këtij plani, tash e tutje sigurisht model do të merret Komuna e Podujevës, ngase sipas vlerësimit të OSBE – së ky plan në aspektin e përbajtjes është më i detajuar dhe më i avancuar.

### **3. Ngritura e grupit punues për hartimin e Raportit të punës për vitin 2015 dhe Programin e punës për vitin 2016**

Grupi punues u ngrit në përbërje si vijon:

1. Shaban Ahmeti,
2. Shaban Osmani, dhe
3. Bahri Selimi

#### **4. Të ndryshme**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, jemi në fund të vitit 2015 dhe dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë në punën këtij Komiteti, në veçanti i falënderoj z. Liman Zeqirin, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe z. Faik Gashin, shef i Zyrës ligjore.

**z. Faik Gashi**, theksoi, është e vërtetë se bashkëpunimi është në nivel mjaftë të lartë, të them me stafin administrativ, por gjithsesi duhet theksuar se bashkëpunimi është i mirëfilltë në radhë të parë të anëtarëve të këtij Komiteti dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të anashkalohet bashkëpunimi i mirë me Policinë e Kosovës dhe Policinë Kufitare, të cilëve duhet shprehur mirënjojje dhe duhet përgëzuar për bashkëpunimin e mirëfilltë e gjithashtu edhe OSBE – në si dhe subjektet e tjera.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, plotësisht pajtohem me parafolësin, unë thash dëshiroj t'i falënderoj të gjitha subjektet për kontributin e dhënë në punën e këtij Komiteti, nuk i përmenda cilat janë ato subjekte por suksesi i punës së këtij Komiteti është i përbashkët dhe i falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë.

**z. Skender Shatri**, përfaqësues i OSBE – së, theksoi, Ju përgëzoj për punën e bërë dhe për atmosferën shumë relaksuese të cilën e keni në punët dhe angazhimet e juaja, këtë e them duke u bazuar në praktiken për punën e Komiteteve për Komunitete të komunave të tjera dhe jam i bindur se mu kjo atmosferë relaksuese ka ndikuar në punën e juaj mjaftë të suksesshme, andaj Ju dëshiroj sukseset e mëtejshme.

**Mbledhja përfundoi në orën 12.20'.**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Faik Gashi**

**Nr. 01-006- 2294**  
**Podujevë,**  
**7 dhjetor 2015**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Shaban Ahmeti**